
POSTIM ARKIVOR

At Anton Harapi në dokumentet e Sigurimit të Shtetit

At Anton Harapi, klerik françeskan dhe figurë e njohur intelektuale shqiptare, u arrestua dhe pushkatua në 1945-ën bashkë me Lef Nosin dhe Maliq Bushatin nga Gjykata Ushtarake e Tiranës.



SEKSIONI

Klerikë

PERIUDHA

1946 - 1946

At Anton Harapi ishte klerik françeskan dhe profesor në Shkodër, me veprimtari arsimore dhe fetare. Pas Luftës së Parë Botërore mori pjesë në veprime atdhetare dhe mbështeti figura si Fan Noli dhe Luigj Gurakuqi . Gjatë pushtimit italian, ai deklaroi se kundërshtoi dhënien e kurorës Mbretit të Italisë. Në vitin 1943 u bë anëtar i Këshillit të Naltë të Regjencës me Lef Nosi dhe Mehdi Frashëri , me arsyetimin e ruajtjes së rendit dhe autoritetit shtetëror. Ai u akuzua për qëndrime antikomuniste dhe lidhje me strukturat bashkëpunuese, ndërsa vetë mohoi përgjegjësi direkte për dënime dhe deklaroi se synonte shmangien e kaosit. Pas luftës nuk u largua nga vendi, u fsheh për një periudhë dhe më pas u arrestua. Figura e tij paraqitet si e përfshirë në rrethana politike të kohës, pa prova për veprime për interesa personale apo kundër integritetit të vendit.

KLERI KATOLIK

PERMBAJTJE #1


Dosja formulare K. 28, 1086-A (1946): Akuza dhe dëshmi mbi Atë Anton Harapin në kontekstin e bashkëpunimit dhe politikës së Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri

Dosja formulare e At Anton Harapit, Kutia nr. 28, Dosja nr. 1086-A, e deklasifikuar më 11.04.2021, përmban materialet hetimore dhe gjyqësore të hartuara dhe administruara gjatë periudhës 31.01.1946 – 11.02.1946, të cilat lidhen me procesin penal ndaj At Anton Harapi në Gjykatën Ushtarake të Tiranës. Dosja përmbledh akt-akuzën zyrtare, procesverbalet e hetimit, dëshmitë e dëshmitarëve dhe deklarimet e të pandehurit, duke e paraqitur atë si figurë të akuzuar për bashkëpunim me pushtuesit italianë dhe gjermanë, përfshirje në strukturat e Regjencës dhe mbështetje të politikave represive ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në materialet e saj përfshihen dëshmi kontradiktore: disa dëshmitarë e lidhin me kontakte dhe bashkëpunim me autoritete gjermane dhe rrethin nacionalist të kohës, ndërsa të tjerë mohojnë përfshirjen e tij në veprime kriminale apo politike, veçanërisht gjatë periudhës së fshehjes pas çlirimit. Në deklarimet e veta, At Anton Harapi paraqitet si klerik dhe intelektual me veprimtari fetare, arsimore dhe publicistike, duke pranuar vetëm pjesëmarrje me karakter institucional në Regjencë për qëllime stabiliteti, por duke mohuar përgjegjësi për vendime represive apo bashkëpunim aktiv në krime. Dosja përfshin gjithashtu korrespondencë zyrtare, shënime hetimore, materiale të dorëshkruara dhe dokumente mbështetëse që pasqyrojnë klimën politike të tensionuar të Shqipërisë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe përplasjet midis narrativës së akuzës dhe mbrojtjes së të pandehurit.

MEDIA #1

Njoftim i pushkatimit të Maliq Bushatit, Lef Nosit dhe Anton Harapit

MEDIA FAQE #1



DREJTORIJA E MBROJTJES POPULLIT
SEKSIONI MBROJTJES POPULLIT
PREFEKTURES ELBASANIT
--ooOoo--
Nr. 401 Prot

800 55
22 "

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit
Elbasan me 14/II/946.

DREJTORISE MBROJTJES POPULLIT

T I R A N E

Ju vemë në dije ni,se me vendimin e Gjykates Ushtarake Tirenes te dates 12/II/946 per deni[illegible]min me vdekje te Def Nosit,Pater Anton Arapit,dhe Maliq Bushatit, populli e priti shume mire kete deni[illegible],dhe qe ne pare e kerkonete qe te tre te pesendunit te denoheshin me vdekje kurese elementet Reaksionar nuk e priten mire,por thonin se dynja ashte kjo,dhe se nji koke do te paguhet me mijre koka ma vone.

. SHEF I SEKSIONIT M.P.
Kapiten i [illegible]-t
(Jan[illegible])

ARSSH

Njoftim i pushkatimit të Maliq Bushatit, Lef Nosit dhe Anton Harapit

INFORMACION

Njoftim i pushkatimit të Maliq Bushatit, Lef Nosit dhe Anton Harapit

Autoret: Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit

DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	200
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Shkodër


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Dëshmia e At Anton Harapit gjatë hetimit të vitit 1945

MEDIA FAQE #1



Simbas ne vojes qe u pa sot me daten 3.IX.945,u muàlle dhe u muare ne pyetje i pandehuri Pater Andon Harapi,i cili mbasi u pyet deklaron:

Une me Jakomonin jam takue ne Tirane kur me asht paraqite rasa me e vizitue per arsye te cilesis s'eme si Kryetar i Francekskanvet,ne Shkoder nuk mbaj mend qe te jemë pare ndonji here me te,mbasi ju tregue fotografija deklaroj se kete fotografi e kane bere ne Theth te Shalles kur une kam qene Drejtor i Internàtistave dhe dy muajte e vere i kaloj-she ne ate vend dhe ka qene detyra e jeme per me dale dhe me shpershendet

P.P. asht e vertete qe ne Shkoder te kemi bame nji mbledhje te gjane ku mershin pjese Gjon Marka Gjoni,Malic Bushati,Mark Gjon Markaj, Shefqet Muka, Sulçe Beg Bushati.Preh kesaj mbledhje doli nji komitetet me kujtohet Se kete Komitet e formojshin tre Muhamedan dhe kater Katolik, nuk mbaje mend nese ka qene nëonji perfaqesues i ushtris.Ne kete mbledhje jane marre vendime por pikat e ketyne nuk me kujtohen.Historia e formimit te kesaj mbledhje ka qene keshtu: Prefekti Shkodres Munir Tershana rapor-ton Qeveris se ndermjet partimave politike ne Shkoder kishte diferençenca te mbedhja politike dhe mbasi gjendja parashifej e kqetsueme u provukue kjo mbledhje,nuk dije me siguri te theksoje se cili kxmtkje nistatori i kesaj mbledhje.Une dhe Cafo Beg Ulqinaku u ndodhem rastesisht ne Shkoder te ftuem prej Prefektures si personalitete politik.

I pandehuri tha se me Gjon Marka Gjonin kam pas takime te shpejta ne Shkoder sidhe me te birin e tij Mark Gjon Markajn,por nuk kam qene dakord me politiken e tyne e sidomos per çeshtjet e Italianvet. pik-pamjet tone ishin te ndryshme dhe une ishe per formimin dhe krijimin e fuqive shtetnore kurse si anonte per me pas fuqina private,per-jashta jam takue ne Rome rastesisht me Gjon Marka Gjonin,por nuk kemi bisedue asnji here per çeshtje politike,prezente ka qene dhe At Gjergj Fishta.Mbasi u lexue letra Nr.1 qe Mark Gjon Markaj i dergon Pater Pal Dodaj,P.P. MxxMxkxixxxxxxxxx Kur kam hye ne regjence kam pas nji respekt per Mehdi Frasherin,por ne vijim te punes se tij e njofta se cili ishte por me gjithe ate e kam tolerue politiken e tij.Mar Gjon Markaj e dinte fare mire se Mehdi Frasheri ishte kundershtare i madhe i tyne dhe ato ne menyre arbitrare kujtojshin se edhe une mbajshe po ate qen-drim kundrejte tyne,kurse ne realitet per mue ishin tamame si Abaz Kupi Mitat Frasheri e tjere.


P.P. Une jam mundue me gjithe forcat e mija per me binde Gjon Marka Gjonin qe te bashkepunonte me ne ashtu siç bashkepunonte Abaz Kupi e Mitat Frasheri,nuk me kujtohet qe t'i keme thane qe te thidhnin"bese" ne Male e te me nipni mundesin per me perkrahe tezen tuaje por ka mundesi qe t'ja kemi thane.

Asht e vertete qe une t'ja keme thase se une nuk du kurse

P.Anton Harapi

Dëshmia e At Anton Harapit gjatë hetimit të vitit 1945

MEDIA FAQE #2



Faqe 11.

te bahet nji opresasion ne anen e Veriut,dhe kesaj mund t'ja arrishe tue u mundue me binde popullin qe mos te merte pjese ne partina politike por te rijshin sejcili ndar shtepiat e veta. Nuk kam pas qellim me keto fjale me thane se duhej luftue levizja Nac.clirimtare,.Nuk mbaje mende qe te keme folur per ndonji operacion ne Tirene dhe kjo te jete folur ne Shkoder.

Fjalet qe jane nenvizue ne letren Nr.2 prej Mark Gjon Markajt se une kam thene: Me hye ne kontakt me gjithekend,poa me i shkrue kerkujte, me le e me lye keto,me heger dhe me thye qafen i mohoj kategorikishte.

Gjermant nuk na kane ndihmue xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx per shkak se nuk na nxejshin bese,kerkesat t'ona ishin per furnizimin e Gjimi armeris dhe keto nuk jane pergjegje.

P.P. Nuk kam pas kurre besim ne forcat e Turkise perkundrazi e kam luftuare qe pat shkruare Eqrem Telhaj ne Bashkimin e Kombit,prandaj nuk mund te jete e vertete qe une ne bisedimet qe kam pas me te mi te permen-durin te jeme çfaqur ne favor te politikes se saje.

Gjeneruli qe permende Mark Gjon Markaj ne letren e trete ka qene Gjeneruli Fistun nuk mbajte mend qe une t'a keme derguare aty,por une e kam gjete,aty.Objekti i bisedimeve nuk me kujtohet.Perse i perket urdhe-nese Nr.6 e firmueme prej Mark Gjon Markajt.Nuk kam dijeni,mbasi me daten 26.Tetuer.1944 une kam pas dhane dorehoqjen mbasi nuk xxxxxxxx prishen dy fjale,mbasi gjermant na grisin me shkue ne nji vend me t'a pa na tregue se ku. Mark Gjon Markaj ka emnue veten si Komandant i Pergji heshem i fu-qive qeveritare te Qarkut Shkodres dhe nuk asht e vertetë qe ky emnin t'i kete dale nga Komiteti i krijuem prej mbledhjes qe theksove ma pare,mbasi Komiteti ne fjale deshtoj.

P.P. Mohoj t'i keme thane Mark Gjon Markajt siç rezulton ne letren Nr.4: Muslimanizma e ka kap shtetin ne dore dhe se asht forte e zoreshme me i bind.....

P.P.Me Haoz Dingun jam pare disa here me ka bame vizite dhe i kam kthye vizite,nuk mbaje mend qe te keme bisduare ndonjihere me te çeshtje politike,shkaku i vizites t'eme ka qene per me nderhye me lirue ndonji prej bungut ose prej internimit,une e kam pas dijte se ka qene i destapos por jo te ket qene Kryetar i sajo,gjermanin Gruza nuk e kam njojtur.

Mohoj ate çka me atribuon austriaku Lopold Dvorag se une per çdo mbremje bisedojshe me Haoz Dingun.

P.P. Mohoj akuzen qe me bahet se une para dates 7.Prill.1939,te keme frekuentue Legaten Italiane tue shkue ndermjete te nji rrugice te erret.

P.P.Jame pare disa here me Mustafa Krujen kam bisedue me të por kemi pase mejtime te kundra politike,mohoj qe te keme popallarizuem ne Shkoder emnin e Mustafa Krujes.

P.P. Mohoj te keme perkrehe ballin Kombetare ma taper se nji parti tjeter,Nuk Palit i kam dhane rekomandime per ne Dukagjin por ketij si nji person vetem ma vone ky asht bame i Ballit Kombetare.Kol Prena asnji here nuk me asht paraqite as me shkrese as me goje.

P.P. Kam bisedue me Zija Dibren e Riza Danin mbaj mend qe t'i keme thane atyre se me dhimbet populli qe po damtohesh e se te keme paraqite mesikun e kalosin tue thane se po na perrajne sllavte,nuk mbaje mend qe te keme thane se plotoforma e politikes se Ballit te ishte ma e parshtetshme se ajo e levizjes Nac.clirimtare.

P.P. Mohoj kategorikishte qe te kete marre pjese dhe te kame kryesue komisjone per me vendose denimin me vdekje te elementeve te Lev.Nac.cl. asht e vertete qe te keme predikue ne Kishen e Francekskanvet ne Shkoder me rrezik e incidentit qe sjellin latru,por nuk asht e vertete qe te keme fole kunder Partis Komuniste.Mohoj te keme zhvillue propagande kunder levizjes na.clirimtare gjate kohes t'ime qe kam qendrue ne ilegalitet.

Mbassi tesh per tesh nuk abeti me gja tjeter,pyetjes ju dha fund tue u ashkrue ky proces si vijon:

I pyeturi. Sekretari Komisioni. Hetimuer

P.Anton Harapi

Dëshmia e At Anton Harapit gjatë hetimit të vitit 1945

INFORMACION

Dëshmia e At Anton Harapit gjatë hetimit të vitit 1945

Autoret: Komisioni Hetimor : Mynir Tirana, Nikolla Profi, Mila Vangjeli

KUTIA	28
DOSJA	323
	200
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Shkoder
	1945-1946


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Proces-verbal i betimit të qeverisë shqiptare para Këshillit të Naltë të Regjencës (5 Nanduer 1943)

MEDIA FAQE #1



60

PROCES VERBAL BETIMI

Vjeti 1943 me 5 Nanduer ne Tirane ne Selin e Keshillit te Nalte te Regjences,

Perpara Shkelqesave Mehdi Frasheri, Lef Nosi dhe Fuat Dibra edhe ne prani te Shkelqeses Pater Anton Harapi [illegible] Sekretari Nedim Kokona, Sekretar i Pergjithshem i Kryesis se Keshillit te Ministrave, hyne :

Shkelqesat Rexhep Mitrovica: Kryeminister dhe Zav;Minist i Kultures Popullore
Dr.Rrok Kolaj Minister i Drejtesise
Ing. Xhafer Deva Minister i P.Mbrendeshme
Dr. Sokrat Dodbiba Minister i Financave
Musa Gjylbega Minister i P. Botore
Agr. Ago Agaj Minister i Ekonomise Komb.
Vehbi Frasheri N/Minister i P. Jashteme
Qazim Bllaca N/Minister i Ekonomise Komb.

te emnuem ne dikasteret e sipershenueme me dekretin e sotem te Keshillit te Nalte te Regjences dhe bane betimin ne formen qe vijon: "Betohem perpara Perendise dhe mbi nderin t'em se kam me qene besnik i Atdheut dhe do te respektoj Statutin dhe Ligjet e Shtetit dhe se do te kryej funksjonet e mija me nder e ndergjegje per te miren e Vendit.

Proces-verbal i betimit të qeverisë shqiptare para Këshillit të Naltë të Regjencës (5 Nanduer 1943)

INFORMACION

Proces-verbal i betimit të qeverisë shqiptare para Këshillit të Naltë të Regjencës (5 Nanduer 1943)

KUTIA	28
DOSJA	323
	200
TIPOLOGJIA E DOSJES	formulare


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Deklaratë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Lacit mbi ndërhyrjen e At Anton Harapit për lirimin e të burgosurve (1944)

MEDIA FAQE #1



KËSHILLI N.Ç.i KATUNDIT TË LAÇIT

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

DEKLARATË

Na,Kryesija e Kshillit N.Ç.të Katundit të Laçit, dishmojmë e vertetojmë,nen pergjegjesin t'onë se,me 6 tetuer,1944, në Katundin t'onë ndolli shka vijon:

Mbas nji sulmi të pashoq e kreshnik,qi bëni çeta e Partizanvet këtû në Laç,kundra ushtrisë barbare gjermane,ku krye në cillën çetë partizane ishte Komisar Brigate Merkur Çela),gjermanët shtuen çetat e veta,sulmuen katundin e dorjen shtatë shpi,bashkë me shpi famullitare.Në ket rast gjermanë plagosen famullitarin,A. Marjan Prêlaj e ne ll tjerë nëpren e dergohen në burgun e ander-shem të Shkoders.

Personat e burgosun jânë këto:P.Marjan Prêlaj famullitar,Ndrè Gjetani Kryetari i Kshillit N.Ç. i Laçit,Pal Marku Sekretar i K.N.Ç.Nikollë Bardhi,Marka Gjini,Gjergj Pali,Nikollë Pasha,Pjeter Nikolle,Nikollë Shkorreti,Marja Gjini,Pal Hilla e Anton Magjolini.

Njoftojmë,pra,se P.Anton Harapi,ky i vetmi,ndërhini e pshtoi shpirtnet e jeten e 12 vetve nalt të permendun,qi ishin nder duer të panshirshme gjermane e në burgun e tyne të rresikshem, tue i lirue prejs burgut e tue kthye të gjith nder shpija të veta.

Kaq na thotë detyra per me lshue ket deklaratë të njoftueme prejs Nesh.

Kryetari i Kshillit N.Ç.i Kat.t,Laçit

Sekretari:
Pal Mark Zinaj

N d r è G j e t a n i

KËSHILLI NLÇ. QL. I KATUNDIT 180

Deklaratë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Lacit mbi ndërhyrjen e At Anton Harapit për lirimin e të burgosurve (1944)

INFORMACION

Deklaratë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Lacit mbi ndërhyrjen e At Anton Harapit për lirimin e të burgosurve (1944)

KUTIA	28
DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Shkoder
	200


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Deklaratë e Besim Viladit mbi qëndrimin e At Anton Harapit gjatë arrestimit të tij (1944–1945)

MEDIA FAQE #1



116

V.F. L.P.

DEKLARATË.

I nenshkruemi Besim Viladi prej Tirane,mbi gjendjen e të pandehurit të burgosun Patër Anton Harapit me ndergjegje të pastër dhe me frikën e Zotit,deklaroj sa më poshtë;

Në muajin e Prorit 1944 disa dit pas terrorit të tmershëm e të paharrushëm që ngjau në Tiranë kam qenë sherbtor në Institutin e Studimeve,të cilin e kryesonte Patër Anton Harapi; në atë kohë jam arrestue prej Major Beqir Kalokut i Regjimentit Kosova tue më konsiderue si të dyshimtë pse veprojshe fshehtazi në favor të Lëvizjes Nacjonal-Çlirimtare;mbasi jam arrestue kanë ardhë e kanë ba një kontroll të imtë në Institut ku më kanë gjetur të fshehur në tavolinën time një revolver me 35 fyshekë dhe pesë bomba plasëse.Atëherë Patër Anton Harapi si ka lënë me i marrë ato,por i ka thënë se këto janë të gjendarmeris s'onë e kështu mua më mbëloj akuzën e rëndë dhe ndermyni për lirimin t'im nga burgu.pas dy muajsh u-lirova e dha urdhën që të më paguhen edhe rrogat e prapambetura.

Këto i vertetoj edhe me bé në rast se thirrem si dishmitar mprojtës për Patër Anton Harapin.

Tiranë 25 gusht 1945

Deklaruesi
Besim Viladi
prej Tiranës sherbtor pranë
Institutit të Studimevet

ARSH

Deklaratë e Besim Viladit mbi qëndrimin e At Anton Harapit gjatë arrestimit të tij (1944–1945)

INFORMACION

Deklaratë e Besim Viladit mbi qëndrimin e At Anton Harapit gjatë arrestimit të tij (1944–1945)

KUTIA	28
DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	200


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Deklaratë e Prof. Injac Gjergj Ndojës mbi arrestimin dhe lirimin e tij gjatë vitit 1943

MEDIA FAQE #1



114

DEKLARATË

I nenshkruemi,Injac Gjergj Ndojaj,profesuer i shqencave në Lyceum të Shtetit,Shkoder,lindun po në këte qytet me 1915,deklaron sa vijon:
në dhetorin e vitit 1943,qeshë kapë e futë në burg,nder arrestimet ma të para qi bani RRegjimenti Kossova qi kishte arrijtë dy ditë ma parë në Shkoder ardhun prej Kossovet.I nenshkruemi,men tmerin e torturat qi ushtrojshin kossovarët mbi t'arrestuemët komunista,ndeji nji javë në burg i akuzuem si komunist i zellëshem,si nji nder elementat ma të rrezikëshem t'agjitacjonit të mbrendëshem dhe si nderlidhës i shokut ilegal,profesor Mark Ndoja.Me këto akuza,sigurisht qi puna e të nenshkruemit do të kishte shkue shumë keq,mos t'ishte kenë Pater Anton Harapi,i cili me nderhymje direkte pranë Xhafer Devës,bani qi të më lirojshin prej burgut.
Gjithashtu gjatë arrestimeve qi bani Hasan Isufi dhe Mato Murati per të grumbullue elementat liri-dashtës dhe luftarë kunder nazi-fashistave,per ti dergue peng nder fushat e perqendrimit të Prishtinës,i nenshkruemi njoftue me kohë per këto arrestime,ka mbetë mëshefë nder Freten,ushqye e mbrojtë,me gjith dijeninë e Pater Antonit.
Mbi sa permban këjo deklaratë,i nenshkruemi qi s ka kurfarë gjinije me Pater Antonin,betohet n'emen të Zotit dhe të nderit të vet.

Prof.Injac Gj.Ndojaj

Shkoder me 14-VII-1945.

Vertetohet nenshkrimi i Ejup Gjyrezit, Noter Publik pranë kesaj Gjykatë.
Shkodrë, me 20.8.1945.

Kryetari i Gjykatës Prefekturës:
(D.Miçaço)

Deklaratë e Prof. Injac Gjergj Ndojës mbi arrestimin dhe lirimin e tij gjatë vitit 1943

INFORMACION

Deklaratë e Prof. Injac Gjergj Ndojës mbi arrestimin dhe lirimin e tij gjatë vitit 1943

KUTIA	28
DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	200


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

Deklaratë e Age Gjon Grudës mbi ngjarjet e Tuzit dhe ndërhyrjen e At Anton Harapit (1943)

MEDIA FAQE #1



V.F.L.P. 110

Une e nenshkruesja,Age Gjon Gruda,me banim ne Tirane deklaroj sa vijon:

Me daten 19 Nershuer 1943 ne Tuz ishin bashkue te gjith burrat e Malcís se Madhe te Shkodres,simbas thirrjes se Dodë Nikolles,e urdhnit te Kole Bibë Mirakaj.Qellimi ishte me shkrue milice e gjendarë burrat e Malcís e me i nise per ne Shqipnín e Jugut kundra Levizjes Nacjonal Clirimtare.

Tue pase folun shumica ne favor,ndërhyna edhe vete ne até çashtje,dhe me fjale te mija e vuna ne beh popullin të hapte sýt dhe mos të dergonte milicë e gjendarë,dhe populli u revoltue kundra dergimit te milicvet,pse ishte nji vlla-vrasje.

Mbas kesaj ngjarje une kjeshe kapë e prû ne burg të Shkodres.Major Dodë Nikolla me Mato Muratin me shoke kerkuen djeqjen teme me benzinë,për të dhanë shembullin barbar kundra kujdo,qi guxonte t'u sabotonte punën.Familja e eme atëhere shkoi te Pater Anton Harapi,dhe ai ndermjetsoi dhe me shpetoi prej vdekjes,shkur toi ditet e mija ne burg,pregatit lirinin tem,dhe ~~xxxx~~ nga ky ndermjetsim u lirue prej burgut edhe vllau i im,i cili ishte kenë kapë bashkë me mua.

deklaroj

Njikohesisht për hirin e se vertetës,se Pater Anton Harapi âsht ai qi keshilloi malsoret e Hotit,të Grudës e të Tuzit,qi t'i hapshin sýt dhe mos t'u gabojshin as vetë as të shtým prej kujdo me u keqsue me asnji partí e me kalue kufinin,për t'u ngatrrue me partizanët malazez.

Për sa shkrova jam gati të deklaroj edhe me gojë si para Qjyqit ashtu edhe para kujdo tjeter,mbasi kjo âsht e vertetë dhe për mue nji detyrë për shka bani për mue.

Deklaruesja

(Age Gjon Gruda)

Age gjon gruda

Deklaratë e Age Gjon Grudës mbi ngjarjet e Tuzit dhe ndërhyrjen e At Anton Harapit (1943)

INFORMACION

Deklaratë e Age Gjon Grudës mbi ngjarjet e Tuzit dhe ndërhyrjen e At Anton Harapit (1943)

KUTIA	28
DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	200


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

Deklaratë e Anton Mazrekut mbi ndërmjetësinë e At Anton Harapit për lirimin nga burgu

MEDIA FAQE #1



113

VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

DEKLARATË

I nenshkruemi Anton Mazreku, ish nëpunës në Ministrin e Arsimit, dhe tashi Profesor në Liceun Shtetnuar të Tiranës, mon pergjegjësin t'eme personale deklaroj:-

Me daten 7/I/1945 beshkë më Nëpunës të tjerë të Ministris s'Arsimit kemë qenë arrestue proj Organeve të Sigurimit Publik t'asaj kohe.-

Vertetoj se votem me ndërmjetësimin e P.Anton Harapit jam lirue nga burgu me daten 10/I/1944.-

Mbi sa deklarova siprì jam gadi t'a parashtroj edhe para gjyqit.-

Tiranë më 4/X/1945

DEKLARUESI
(Anton Mazreku)

AIDSSH

Deklaratë e Anton Mazrekut mbi ndërmjetësinë e At Anton Harapit për lirimin nga burgu

INFORMACION

Deklaratë e Anton Mazrekut mbi ndërmjetësinë e At Anton Harapit për lirimin nga burgu

KUTIA	28
DOSJA	323
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	200

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.